

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
ME SELI NË TIRANË
" Sustainable Institute" sh.p.k.

Sot, më datë 04.07.2022 (dymijë e njëzetedy):

- 1. Z. Sokol Kraja**, i biri i Gani dhe Ixhlah, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 04/06/1969, lindur në Tiranë dhe banues në adresën *Rruga Bardhok Biba, Galeria e Tiranës, Nr. 17, Tiranë, Shqipëri*, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr.G90604128G
- 2. Shoqëria Real Asset Group shpk**, e regjistruar ne Qendrën kombetare të Biznesit me NUIS M21901024C, me seli ligjore ne adresën në Rruga Themistokli Gërmenji, Pallati Pegaso, Kati 1, Ap. Nr 2, Njësia Administrative nr 2, Tiranë, Shqipëri përfaqësuar nga administratopri i saj z. Oltjan Hoxholli, shtetas shqiptar, lindur më 29.09.1981 në Tiranë, banues në Njësia Bashkiake nr 5, Rr. Gjin bue Shpata, Nd 1834, H.1, Ap 008, Kodi postar 1019, Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal I10929118F,

Ne baze te vullnetit tone te lire dhe mbeshtetur ne Ligjin 9901 date.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar, dhe vecanerisht neni pika 2, dhe ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” vendosëm të themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që do të veprojë sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1

Themelimi

- 1.1. Shoqëria tregtare “Sustainable Institute” sh.p.k. themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit n. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, (në vijim Shoqëria).
- 1.2. Shoqëria është një person juridik shqiptar.

NENI 2

Emri e shoqërisë dhe vula


- 2.1. Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj “Sustainable Institute” sh.p.k. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

- 3.1. Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj me objektin që vijon:

3.2. Kultivimi, prodhimi, përpunimi, tregtimi i produkteve bujqësore, ushqimore dhe shitja e tyre brenda vendit dhe për eksport. Rritja dhe mbarështimi i blegtorisë, prodhimi dhe përpunimi i produkteve blegtorale dhe tregtimi i tyre brenda vendit dhe për eksport; aktivitete te tjera ndihmese për veprimtarinë bujqësore dhe blegtorale. Kryerja e studimeve shkencore, laboratorike, implementimi i tyre ne terren, ne bashkepunim me Institucionet shkencore vendase dhe te huaja



qe kane lidhje me Bujqesine, Blegtorine, Pyjet dhe Ujerat. Ndertimi i objekteve te vlefshem per Bujqesine, blegtorine, pyjet dhe ujerat.

3.3. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj duke u bazuar tek autorizimet dhe/ose lejet e lëshuara nga institucionet qeveritare kompetente të fushës.

NENI 4

Qendra ligjore

2.1. Shoqëria do të ketë qendrën e saj ligjore në adresën Autostrada Tirane-Durres, km 8.8, Picar, Zona Kadastrale nr 3974, Nr pasurie 249/76, Vorë, Shqipëri.

2.2 Shoqëria mund të hapë edhe qendra dytësore, filiale, degë, zyra përfaqësimi dhe degë, në rrethe të tjera të vendit ose jashtë shtetit.

2.3. Transferimi i selisë brenda territorit të së njëjtës bashki është kompetencë e organit administrativ.

NENI 5

Kapitali Themeltar

5.1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj shoqërie, në lekë. Kontributi në para do të jetë i përbërë prej dy kuotash me vlerë 100,000 (njëqindmijë) lekë.

5.2. Ortakët themelues të shoqërisë zotërojnë kuotat si vijon:

Z. Sokol Kraja, i biri i Gani dhe Ixhlat i datëlindjes 04/06/1969, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të kapitalit themeltar të barabartë me 1 kuotë me vlerë 50,000 (pesëdhjetëmijë) lekë

Shoqëria Real Asset Group shpk, e regjistruar ne Qendrën kombetare të Biznesit me NUIS M21901024C, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të kapitalit themeltar të barabartë me 1 kuotë me vlerë 50,000 (pesëdhjetëmijë) lekë

5.3. Vlera dhe pagesa e kapitalit themeltar do të kryhet në momentin e nënshkrimit të këtij akti themelimi.

5.4. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet dhe me anë të kontributeve në natyrë ose të drejtave, në përputhje me parashikimet e ligjit n. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

5.5. Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë mund t’u përcaktohet ortakëve edhe në mënyrë jo proporcionale më kontributin e kapitalit që ata japin në shoqëri.

5.6 Në raste përjashtimore zmadhimi i kapitalit mundet të realizohet edhe nëpërmjet ofrimit të pjesëmarrjes në kapital të palëve të treta; në këtë rast ortakët ekzistues kanë të drejtën të tërhiqen nga e drejta e parablerjes së kuotave të zmadhimit të kapitalit.

NENI 6

Kohëzgjatja e Shoqërisë

6.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik me afat të papërcaktuar. Kohëzgjatja e shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

NENI 7

Organet e drejtimit

7.1. Në referim të ligjit n. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, organet e drejtimit të shoqërisë janë:

1. Aambleja e Përgjithshme e ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë;

7.2. Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve përcaktohet nga Statuti i shoqërisë.

7.3. Shoqëria administrohet nga Administratori, i zgjedhur për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë përtëritje të mandatit. Administratori i shoqërisë do të jetë zonja Z. Sokol Kraja, i cili e ka pranuar këtë detyrë nga data 4.07.2022 – 4.07.2027.

7.4. Shoqëria përfaqësohet përpara çdo organi të administratës, organi gjyqësor, enti publik ose privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori, i cili ushtron këtë pushtet në bazë të dispozitave të Statutit të shoqërisë dhe legjislacionit në fuqi.

NENI 8

8.1. Audituesi ligjor do të emërohet sipas legjislacionit në fuqi, për çdo vit ushtrimor shoqëria do të emërojë një auditues ligjor për të kontrolluar pikërisht veprimtarinë e vet ekonomike, nëse kërkohet nga ligji emërimi i një eksperti kontabël.

NENI 9

9.1. Ortakët e shoqërisë mund të vendosin në mënyrë vullnetare të marrin pjesë në shoqëri të tjera, si dhe të ushtrojë çdo veprimtari private, me përjashtim të kufizime të parashikuara nga ligji.

NENI 10

10.1. Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, krijimi i degëve ose filialeve, do të bëhen në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit dhe të statutit.

NENI 11

11.1. Ortakët e shoqërisë detyrohen të ruajnë sekretin për themelimin dhe veprimtarinë e shoqërisë. Vartësit dhe drejtuesit e drejtimit të shoqërisë janë përgjegjës dhe detyrohen të shpërblejnë dëmet shkaktuar shoqërisë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.

NENI 12

Legjislacioni i aplikuar

12.1. Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i nënshkruar nga Ortakët themelues dhe në pajtueshmëri me normativën shqiptare në fuqi.

NENI 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

13.1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ortakëve dhe shoqërisë do të zgjidhen me marrëveshje ndërmjet tyre dhe, nëse kjo nuk do të ndodhë, nga gjykata kompetente.

NENI 14

Dispozita përfundimtare

14.1. Akti i themelimit redaktohet në katër kopje identike në gjuhën shqip dhe u nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKËT THEMELUES

Sokol KRAJA

Real Asset Group shpk

Përfaqësuar nga Adminsitratori

Oltjan HOXHOLLI



